

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE REZARTA B. KOÇI

Nr. 2477 Rep.

Nr. 791 Kol.



KONTRATE SHIT-BLERJE

Kuotave te shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K

**Baza Ligjore
Nenet 6, 705-750 te Kodit Civil**

Në Tiranë, sot më 02.04.2019 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta B.Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën "Bulevardi Zogu i I", përballë "Ministrisë së Drejtësisë", Njësia Bashkiake Nr. 9, u paraqiten personalisht:

SHITESI: Z. Nikolle Ndoci, i datëlindjes 01.08.1967, lindur në Gjadër, Lezhë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 024432853 dhe me nr. personal **G70801069S**

BLERESI: Z. EMIN CASKAN lindur me 20.04.1976, ne Izmir, Turqi, shtetas Turk, i identifikuar me ane te pasaportës me nr. S20076171, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

BLERESI: Znj. PERÇIN CASKAN lindur me 12.05.1978, ne Izmit, Turqi, shtetase Turke, e identifikuar me ane te pasaportes me nr. S20061488, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Palët, me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe ne mirëkuptim te ndërsjelle, me kërkuan redaktimin e kësaj kontrate, ne kushtet dhe me te dhënat e mëposhtme:

TE DHENA PARAPRAKE

- I. Shitësi është ortak i 20% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K, me NIPT L91528508S, themeluar dhe regjistruar me date 25.03.2019, me seli ne adresen: " Durrës, Rrashbull, banesa me nr. pasurie 94/175, Zona Kadestrale nr 3215, kati I-re.
- I. Shoqëria "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K, me vendimin nr 1, date 02.04.2019 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve kane dhëne pëlqimin për shitjen 20 % te kuotave te kapitalit themeltar te "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K nga totali i kuotave prej 20% te ortakut Z. **Nikolle Ndoci**, ne cilësinë e shitësit, tek blerësit Z. **EMIN CASKAN** dhe Znj. **PERÇIN CASKAN**, përkatësisht ne vlerat 10% tek secili blerës.
- II. Ne baze te Udhëzimit nr 2007/1, date 2.3.2010 te Ministrit te Drejtësisë dhe Ministrit te Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes është kërkuar informacion nga noteri sipas njoftimit D pranë Regjistrimit te Barreve Siguruese dhe nga përgjigja e dhëne nga RBS, rezulton se mbi kuotat e kapitalit themeltar te shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K, nuk rezulton asnjë barre siguruese.

NENI 1
Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë së luajtshme sipas kuotave të përcaktuara më poshtë, të kapitalit themeltar të shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K, nga shitësi në favor të palës blerëse.

- **Z. Nikolle Ndoci**, shet 20% nga pjesa e vet prej 20% të kuotave me vlerë nominale 20 000 (njëzetë mijë) lek.

NENI 2
Çmimi

2.1 Shitësi ia shet këtë pasuri blerësit kundrejt një çmimi dhe përkatësisht sipas ndarjes:

- a) **Z. Nikolle Ndoci**, shet 10% nga pjesa e vet takuese prej 20% të kuotave të shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K me vlerë nominale 10 000 (dhjetë mijë) lek, të cilat i blen **Z. EMIN CASKAN**.
- b) **Z. Nikolle Ndoci**, shet 10% nga pjesa e vet takuese prej 20% të kuotave të shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K me vlerë nominale 10 000 (dhjetë mijë) lek, të cilat i blen Znj. **PERÇIN CASKAN**.

2.2. Palët deklarojnë se çmimi është paguar nëpërmjet llogarisë bankare nga blerësi në favor të shitësit, të cilët nuk kanë asnjë pretendim.

2.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje kuotash dhe regjistrimin e saj në QKB, **Z. Nikolle Ndoci** largohet si ortak nga Shoqëria "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K, si dhe si bashkë administrator i Shoqërisë, ndërsa pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet e tyre do të jetë:

- 1- **Z. EMIN CASKAN** - zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) leke të reja që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2- Znj. **PERÇIN CASKAN** – zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) leke të reja që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 3
Te drejtat dhe detyrimi i palëve

3.1 Shitësi garanton blerësin për titullin e pronësisë të pasurisë objekt kontrate dhe saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mban përgjegjësi civile për demin e shkaktuar.

3.2 Shitësi është i detyruar të dorëzojë pasurinë objekt kontrate me gjithë dokumentacionin përkatës blerësit, me marrjen e pagesës nga ky i fundit.

3.3 Shitësi është i detyruar të dorëzojë pasurinë objekt kontrate blerësit të shkarkuar nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve.

3.4 Blerësi ka detyrim të njoftojë brenda 5 ditëve shitësin në rast se të tretë ngrëne pretendime pronësie mbi sendin objekt kontrate.

NENI 4
Kalimi i pronësisë

Me nënshkrimin e kontratës, shitësi **Nikolle Ndoci** zhvishet plotësisht nga pronësia mbi 20% (njëzetë për qind) të kuotave si me sipër dhe ajo i kalon e plotë blerësve. Blerësi, zoti **EMIN CASKAN**, behet zotëruar i 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & CO".SH.P.K dhe në bazë të Vendimit të Ortakëve, behet ortak i Shoqërisë me 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave. Blerësi, Znj **PERÇIN CASKAN**, behet

zotërues i 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "HEALTHCARE PARTNERS & COMPANY" dhe në baze të Vendimit të Ortakëve, behet ortak i Shoqërisë me 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave.

NENI 4 Te ndryshme

5.1 Palët u porositen që të depozitojnë këtë kontratë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5.2 Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre ehte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Duke qene se njeri nga palët e kësaj kontrate është shtetas i huaj dhe nuk flete kupton gjuhen shqipe, kjo kontrate ju lexua ne gjuhen angleze, gjuhe te cilën e kupton, ne prani te përkthyeses se certifikuar te gjuhës angleze, Znj Mira Zgjani.

Kontrata iu lexohet të palezete cilët e kuptojnë, pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

Kontrata redaktohet në 4 kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike. Bashkëlidhur kësaj kontrate janë Regjistri i Barreve Siguruese dhe kopje e ekstraktit të QKB-se të Shoqërisë. Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar), si dhe në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj prokure të përgjithshme në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITESI

Nikolle Ndoci

Nikolle Ndoci

E pranishme në nënshkrim
Përkthyesja:

MIRA ZGJANI

Mira Zgjani

BLERESI

EMIN CASKAN

PERÇIN CASKAN

EMIN CASKAN
PERÇIN CASKAN

NOTERE

PERÇIN CASKAN
EMIN CASKAN



VENDIM NR. 1

I

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “HEALTHCARE PARTNERS & CO”

Sot, me date 02.04.2019, e thirrur nga Administratori i Shoqërisë me Përgjegjësi te Kufizuar HEALTHCARE PARTNERS & CO, Zoti Nikolle Ndoci, asistuar nga përkthyesja e gjuhës angleze Znj. Mira Zgjani, u zhvillua mbledhja e Asamblesë se Ortakeve te Shoqërisë.

Ne këtë takim morën pjese Ortaket:

- 1- **Z. EMIN CASKAN**
- 2- **Znj. PERÇIN CASKAN**
- 3- **Z. Nikolle NDOCI**

Përveç te tjerash, Asambleja e Ortakeve, pasi dëgjoj kërkesën e ortakut, përkatësisht zotit **Nikolle Ndoci**, për shitjen e 20% te kuotave te zotëruara prej tij ne Shoqëri, si dhe faktit qe ortaket tjetër shprehen interes për blerjen këtyre kuotave, vendosi:

1. Miratimin e shitjes se 20 % te kuotave te Shoqërisë me Përgjegjësi te Kufizuar “HEALTHCARE PARTNERS & CO”, te zotëruara nga ortaku **Z. Nikolle Ndoci**, tek 2 ortaket e tjerë, përkatësisht ne vlerën 10% tek secili ortak, duke njohur dhe miratuar kështu njëkohësisht dhe **largimin e Ortakut** Nikolle Ndoci nga Shoqëria, si dhe nga funksioni i **Administratorit**.
2. Largimin si bashke administrator te Znj. **PERÇIN CASKAN**.
3. Pjesëmarrja e ortakeve ne kapitalin e Shoqërisë, pas kalimit te kuotave, ne përputhje me kontributet ne kapitalin e tyre do te jete si me poshtë:
 - **Z. EMIN CASKAN** - zotërues i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme prej 50000 (pesëdhjete mije) leke te reja, qe përben 50% te kapitalit te Shoqërisë.
 - **Znj. PERÇIN CASKAN** - zotërues i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme prej 50000 (pesëdhjete mije) leke te reja, qe përben 50% te kapitalit te Shoqërisë.
4. Kalimi i kuotave te behet ne përputhje me detyrimet qe rrjedhin nga Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë.



- 4- Shoqëria do të vazhdojë të Administrohet nga ortakët e saj, zoti **EMIN CASKAN**, për një periudhë 5 vjeçare.
5. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë zoti **EMIN CASKAN**, vete ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, të kryejë regjistrimet e ndryshimeve pranë QKB sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, i ndryshuar, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,

Mbyllet me numrin 5 (pese)

Ky vendim, pasi u redaktua dhe u lexua me zë të lartë në gjuhën angleze dhe u gjet në përputhje me vullnetin e ortakëve u nënshkrua nga ana e tyre.

ORTAKET

Z. EMIN CASKAN

Emin Caskan

Znj. PERÇIN CASKAN

Perçin Caskan

Z. Nikolle NDOCI

Nikolle Ndoci



Përkthyesë e gjuhës angleze

Mira ZGJANI

Mira Zgjani

[Signature]



RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20190402151552791
Data e Rezultatit të Kërkimit: 02.04.2019
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 3:15:52PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-626-1525
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

HEALTHCARE PARTNERS & CO SH.P.K.





RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX.: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

FATURË

Emri i Perdoruesit: REZARTA
BESNIK
KOCI

Adresa: RR EMIN DURAKU
TIRANE-TIRANE
SHQIPERI

Nr. i Llogarise: 400-626
Date: 02.04.2019
Pershkrimi: D-20190402151552791

Balanca Perpara: Leke 10,200.00
Debi Leke 1,400.00
Balanca Aktuale: Leke 8,800.00

Komente: Pagese kerkim regjistrimi



600 kemoni